



## REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH. II.nr.1036/2023

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË-Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ramush Bardiqi, kryetar i kolegjit, Krenar Berisha dhe Dren Rogova anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike të paditësit Globi-M shpk me seli ne Gjilan kundër te paditurit Komuna e Kamenicës, me baze juridike padi për pasurim pabazë me propozim për caktimin e masës se sigurimit duke vendosur lidhur me konfliktin për kompetencë ndërmjet Dhomave te shkalles se parë, Departamenti për Çështje Ekonomike dhe Departamentit Administrativ te Gjykatës Komerciale ne Prishtinë në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 31.08.2023, mori këtë:

### A K T V E N D I M

Për te gjykuar ne këtë Çështje juridike kompetenca lëndore është Gjykata Komerciale ne Prishtine-Dhomat e shkalles te shkalles se parë-Departamenti për Çështje Administrative, te cilës i dërgohen shkresat e lendes ne procedurë te mëtejshme.

Kundër këtij aktvendimi ankesa është palejueshme ne kuptim te nenit 26.3 te LPK

### A R S Y E T I M

Paditësi me dt. 29.03.2023 ne Gjykatës Komerciale-Dhomave te shkalles e parë-Departamenti për Çështje Ekonomike ka parashtruar padi pasurim pabazë me propozim aprovohet padia dhe te anulohet vendimet e te paditurës Komunës se Kamenicës nr. Prot. 9384 i dt. 17,03,2023 dhe nr. Prot 2085 dt.19.01.2023 si dhe ka kërkuar caktimin e masës se sigurimit.

Gjykatën Themelore ne Prishtine-Departamenti për Çështje Ekonomike me aktgjykimin nr. II EK nr. 283/23 i dt. 19.06.2023 është shpall Jo kompetent ne pikëpamje lëndore dhe ka konsideruar se kompetent për trajtimin e kësaj çështje juridike te është kompetent Departamenti administrativ i Gjykata Komerciale ne Prishtine.

Me Aktvendimit nr. KP. Nr. 286/23 Gjykatës Komerciale-Dhomave te shkalles e parë-Departamenti i administrativ ka hape konflikt për kompetence në Gjykatën Komerciale Dhomën

me arsye se nuk ka pranuar kompetencën lëndore ne këtë kontest duke vlerësuar se ne kuptim te nenit 13 paral.1 te Ligjit për gjykatën Komerciale nr. 08/L-15 “Gjykata Komerciale është kompetente për të gjykuar, dhe ka juridiksion ekskluziv për të gjykuar, në Dhomat e Shkallës së Parë dhe Dhomat e Shkallës së Dytë: 1.1. kontestet ndërmjet shoqërive tregtare vendore dhe të huaja, si dhe kontestet ndërmjet personave juridikë publikë dhe privat, në lidhje me çështjet e ndërsjella tregtare dhe çështje tjera mes tyre”.

Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale pas shqyrtimit te shkresave të lëndës ka gjetur se ne këtë çështje juridike kompetencë lëndore për të vendosur është Gjykata Komerciale ne Prishtine-Dhoma e shkalles se parë-Departamenti për Çështje Administrativ, për arsye se, në baze te nenit 13 paragrafi 1 pika 1.12 te ligjit për Gjykatën Komerciale nr. 08/L-15 shprehimisht është përcaktuar se Dhomat e shkalles se parë-Departamenti për Çështje Administrative i Gjykatës Komerciale ne Prishtinë është kompetent me gjykuar ne shkallë te pare. *kontestet administrative të iniciuara nga shoqëritë tregtare kundër vendimeve përfundimtare në procedurë administrative; ndërsa* prag 5 te këtij neni përcakton se “Të gjitha çështjet e përcaktuara në nënparagrafin 1.12 të paragrafit 1 të këtij neni do të trajtohen në shkallë të parë nga Departamenti për Çështje Administrative. Ne rastin konkret nuk kemi të bëjmë me kontest lidhur me çështje afariste por kontest për anulimin e Vendimit të Organit Administrativ te se paditurës Komuna e Kamenicës.

Gjykata Komerciale ne Prishtine-Dhoma e shkalles se parë-Departamenti për Çështje Ekonomike, në baze te nenit 13 paragrafi 1 pika 1.1 lidhur prag 2 te këtij neni te ligjit për Gjykatën Komerciale nr. 08/L-15 shprehimisht është përcaktuar se Dhomat e shkalles se parë-Departamenti për Çështje Ekonomike i Gjykatës Komerciale ne Prishtinë është kompetent me gjykuar ne shkallë te pare: *kontestet ndërmjet shoqërive tregtare vendore dhe të huaja, si dhe kontestet ndërmjet personave juridikë publikë dhe privat, në lidhje me çështjet e ndërsjella tregtare dhe çështje tjera mes tyre*”. Ndërsa në rastin konkret paditësi ka kërkuar nga gjykata anulimin e aktit administrativ të së paditurës, e cila çështje nuk përbën afarizëm të ndërsjellë mes palëve.

Ngase u tha më lartë e në pajtim me dispozitën e nenit 13 nen parag 6 i Ligjit për Gjykatën Komerciale nr. 08/L-15 dhe 25 te LPK, u vendos si ne dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË

Dhoma e Shkallës së Dytë

K.DH.SH.II nr.1036/2023 datë 31.08.2023

Kryetari i Kolegjit – gjyqtari  
Ramush Bardiqi